



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/82


Datë: 15/12/2023

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 28, paragrafi 1.6 të Statutit të UP-së dhe nenin 6 të Rregullores nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të punës së Senatit të UP-së, thërret mbledhjen e 50-të, të rregullt të Senatit, me këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së 49-të të Senatit të UP-së, mbajtur me datë 30.10.2023;
2. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me propozimet e këshillave të njësive akademike për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, sipas Konkursit me nr. prot. 1/331, datë 31.5.2023;
3. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me Raportin me nr. të prot. 4/455, dt. 15.11.2023, raportit me nr. të prot. 4/674, dt. 27.11.2023 dhe raportit të datës 13.12.2023, të Komisionit për ankesa dhe parashtrës të Senatit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me nr. prot. 4/758, datë 1.12.2023) të Komisionit të veçantë të ankesave lidhur me pozitat e asistentëve në Fakultetin Juridik, sipas pikës XV. Promovimi i kthimit të trurit, të Konkursit me nr. prot. 1/131, datë 31.5.2023;
5. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me zgjedhjen në pozitat e asistentëve në Fakultetin Juridik (Buletini nr. 28, datë 27.10.2023), sipas pikës XV. Promovimi i kthimit të trurit, të Konkursit me nr. prot. 1/131, datë 31.5.2023;
6. Njoftimi i Senatit të UP-së, lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetin e Arkitekturës, Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Bujqësisë dhe të Veterinarisë, sipas Konkursit plotësues me nr. prot. 2/724, datë 2.11.2023;
7. Marrja e vendimit lidhur me propozimin e Fakultetit të Filologjisë, për angazhimin e profesorëve dhe lektorëve vizitorë, për vitin akademik 2023/24;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për lejimin e temave të doktoratës dhe të mentorëve, sipas raportit të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës;
9. Shqyrtimi i kërkesave për ratifikim të punimeve të doktoratës, sipas raportit të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës;
10. Marrja e vendimit për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për studime themelore/bachelor
11. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me propozimin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, për numrin e studentëve të lejuar në programet në ri-akreditim:
 - 11.1. Programet e nivelit Bachelor:
 - Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike - 260 studentë,
 - Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë - 120 studentë,
 - Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit - 80 studentë.
 - 11.2. Programet e nivelit Master:
 - Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike - 50 studentë,
 - Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë - 30 studentë,
 - Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit - 20 studentë.
12. Marrja e vendimit për listën e profesorëve të angazhuar në Programin Master të Fakultetit Juridik "Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice"
13. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ditën e hënë, me datë 18.12.2023, me fillim prej orës 10:00.



Kryesues i Senatit të UP-së:

Prof. dr. Qerim Qerimi, rektor